



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 35, datë 11.06.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“TIRANA BUSINESS PARK” , FAZA E NDËRTIMIT 1, ME VENDNDODHJE NË
RRUGËN E RINASIT, BASHKIA VORË, ME SUBJEKT ZHVILLUES SHOQËRINË
“TIRANA BUSINESS PARK” SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimi Nr. 34, datë 20.11.2024 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e procedurave administrative për mënyrën e përfundimit të punimeve, prishjen apo konfiskimin e ndërtimit për punimet e filluara prej më shumë se dhjetë vjetësh dhe ende të papërfunduara”, Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Tirana Business Park” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Tirana Business Park”, Faza e ndërtimit 1, me vendndodhje në Rrugën e Rinasit, Bashkia Vorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Tirana Business Park” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 20.08.2012 të Komunës Prezë, shtyrë afati i Lejes së Ndërtimit me Vendimin Nr. 9, datë 30.05.2014 të Komunës Prezë, me Vendimin Nr. 8, datë 05.05.2015 si dhe me Vendimin Nr. 22 datë 10.06.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, synon të fuqizojë menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

KRYETARI

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU

A large, stylized handwritten signature in blue ink is written over the text and the official stamp. The stamp is circular, with the text "REPUBLIKA E SHQIPËS" at the top, "MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" around the perimeter, and "TIRANË" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

A large, stylized handwritten signature in blue ink is written over the text and the official stamp. The stamp is circular, with the text "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT" around the perimeter and "TIRANË" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.

Nënshkruar më datë 22 10 / 2025